



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS DHE
INVESTIMEVE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2019

Lënda: Informacion mbi situatën e ndriçimit në zonat periferike të qytetit të Shkodrës

Drejtuar: _____

Rr. _____, Shkoder

Në përgjigje të kërkesës suaj me nr.7996 dt. 10.06.2019, drejtuar Bashkisë Shkodër, në të cilën, bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” kërkon informacion mbi “Situatën e ndriçimit në zonat periferike të qytetit të Shkodrës”, ju bëjmë me dije se:

Si fillim me ndarjen e re administrative qyteti i Shkodrës ndahet në 5 lagje, dhe asnjëra nga këto lagje nuk ka përkufizimin e zonës periferike të qytetit. Për të përcaktuar zonën periferike të qytetit do të marrim si referim unazën rrugore të qytetit, pra periferi e qytetit të Shkodrës do të quhet zona përtej unazës së qytetit.

Pasi e përcaktuam këtë emërtim, në këtë zonë kemi këtë situatë:

- Zona Jugore e qytetit paraqitet me mbi 70% e ndriçuar, ku vlejme të përmendim edhe investimin e fundit në ndriçim në Bahçallek. Një investim që po planifikohet në këtë zonë është ai i pazarit të vjetër të Shkodrës ku do ketë ndriçimin përkatës.
- Zona Perendimore e qytetit paraqitet më problematikja me 50% të rrugëve të ndriçuara, pasi është zonë me ndërtime të reja, por vlen të përmendim që ndriçimi është i pranishëm në disa rrugë si: Rruga Hoxha Tasim, Rruga Shtëpia e Bujqve, Rruga Mustafë Dervishi, Rruga Karvanej etj. Po ashtu në këtë zonë për vitin 2019 parashikohet të instalohet ndriçimi në rrugët si: Rruga Udha e Kryqit (konvertohet në LED), Rruga Nuri Dervishi (konvertohet në LED), Rruga Lamijej, Rruga Muharrem Dragovija.
- Zona Veriore e qytetit është edhe zona më e vogël periferike e qytetit të Shkodrës pasi ka në afërsi të saj Njësinë Administrative Rrethina, ku fillon shumë afër unazës së qytetit. Kjo zonë ka ndriçim në rreth 70% të territorit, dhe një ndër planifikimet për të ardhmen në këtë zonë është Rruga Golemit.
- Zona Lindore e qytetit është zona përgjatë Lumit Kir. Në këtë zonë Bashkia Shkodër ka investuar vazhdimisht në ndriçim, ku mund të përmendim investimet e fundit: Rruga Treni i Madhrave, Rruga e Martirëve, Rruga Anton Ashta, Rruga Lundërtune (ndriçim LED), Rruga Pjetër Spani, Rruga Lugoçezme, Rruga Draçin etj. Për vitin 2019 në këtë zonë parashikohet të investohet në ndriçim: Rruga e Foljetave, Rruga Qafa e Bishtkazit.

Duke ju uruar mbarëvajtje në punë!

KRYETAR

Voltana ADEMI